



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

---

**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**KRYETARI I KOMUNËS**

01. nr. 031 - 104702, më 28.4.2016

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më 28.4.2016, merr këtë

**V E N D I M**

I. CAKTOHET komisioni për evidentimin e shfrytëzuesve të hapësirave publike para objekteve afariste - hoteliere.

II. Anëtarë të komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi, janë:

1. Enver Kadriu, kryetar,
2. Ilir Demaj, anëtar,
3. Sabri Gashi, anëtar,
4. Skënder Gashi, anëtar,
5. Valon Sherifi, anëtar,
6. Afrim Braina, anëtar.

III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, janë: të mbledhë të gjitha të dhënat e domosdoshme dhe të bëjë matjen, kalkulimin-faturimin dhe dhënien e pëlqimeve për shfrytëzuesit që i plotësojnë kriteret e parapara sipas Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 157481, të dt. 1.7.2014, lidhur me shfrytëzimin e

hapësirave publike nga subjektet afariste.

IV. Për kryerjen e detyrave të caktuara në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

